



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME PLENARE TË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 5 MARS 2026, ora 22.00**

**SA VANREDNE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 5. MARTA 2026. GODINE, 22.00 časova**

**MARS - MART
2026**

Rendi i ditës

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Dnevni red

1. Izbor Predsednika Republike Kosovo.

Seancën e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Albulena Haxhiu.

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër Kurti,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë,

Media që po e përcillni këtë seancë!

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të thirrur me kërkesën e 42 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Po votojmë së pari për prezencë. Regjia, votojmë tash!

Sipas votimit janë 64 deputetë të pranishëm, 56 deputetë nuk janë të pranishëm.

Ta konfirmojmë edhe një herë, atëherë edhe sipas monitorit që e keni përpara, 64 deputetë janë të pranishëm. Me këtë rast po i ftoj deputetët, të cilët nuk janë të pranishëm që të vijnë në seancë, sepse edhe aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese kërkojnë prezencën e tyre. Konstatoj se kemi kuorum të mjaftueshëm për procedim.

Fillojmë me pikën e vetme të rendit të punës për këtë seancë:

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës

Më lejoni fillimisht t'i adresoj disa sqarime të rëndësishme. Sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin numër KO 2911 lidhur me votimin në Kuvend, në pikën 85 thuhet: "Gjykata vëren se lidhur me numrin e votave që kërkohet për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, neni 86.4 i Kushtetutës siguron se Presidenti i Republikës së Kosovës do të zgjidhet me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, pra 2/3 e 120 deputetëve, minus ata deputetë, të cilët kanë marrë leje nga Kryetari i Kuvendit dhe kandidati i cili merr 80 ose më shumë vota nga votat e të gjithë deputetëve në raundin e parë dhe të dytë do të zgjidhet".

Ju njoftoj se unë nuk kam marrë asnjë njoftim nga deputetët, të cilët sot nuk janë të pranishëm për arsyt pse ata mungojnë. Prandaj, edhe një herë në cilësinë e Kryetares së Kuvendit dhe bazuar edhe në aktgjykime të Gjykatës Kushtetuese kërkoj nga deputetët e Kuvendit, të cilët nuk janë të pranishëm, që të vijnë në seancën për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës. Po ashtu, Gjykata i referohet nenit 70, mandatet e deputetëve të Kushtetutës, i cili përcakton se deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit.

Për më tepër lidhur me obligimin e tyre si deputetë neni 74 ushtrimi i funksionit i Kushtetutës siguron deputetët e Kuvendit të Kosovës do të ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe sipas Kushtetutës, ligjeve dhe Rregullores së Punës së Kuvendit.

Në këto rrethana të gjithë 120 deputetët e Kuvendit, thuhet në aktgjykim, duhet të ndihen të obliguar sipas Kushtetutës, Ligjit për deputetë, Rregullores së Kuvendit dhe Kodit të sjelljes të marrin pjesë në seancat plenare të Kuvendit dhe të përkrahin procedurat që parashihen aty, por mbi të gjitha një obligim viza-vijë për njerëzit e Kosovës që i zgjedhën ata.

Gjithnjë po i referohem aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Zgjedhja e presidentit të Kosovës, i cili sipas nenit 83, statusi, presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e njerëzve të Republikës së Kosovës, është i një rëndësie kaq të madhe sa që të gjithë deputetët si përfaqësues të popullit të Kosovës duhet ta konsiderojnë si detyrë kushtetuese të tyre, përveç nëse u lejohet nga kryetari i Kuvendit të mos marrin pjesë në procedurën për zgjedhjen e presidentit, siç përcaktohet në nenin 86.

Pra, edhe një herë për sqarim, asnjë nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilët sot nuk janë të pranishëm, nuk kanë marrë leje nga unë sipas asaj që thuhet në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese për të munguar në seancën për zgjedhjen e presidentit dhe, po ashtu, as nuk më kanë njoftuar për arsyet e mungesës së tyre.

Edhe një herë si kryetare e Kuvendit, bazuar në aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese ftoj deputetët, të cilët nuk janë të pranishëm në këtë seancë që të vijnë dhe t'u përmbahen përgjegjësi kushtetuese.

Po votojmë edhe një herë për prezencë. Regjia, ju lutem!

66 deputetë janë të pranishëm në këtë seancë.

54 deputetë nuk janë të pranishëm në këtë seancë.

Unë në këtë rast ftoj që në mbështetje të nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për President të Republikës së Kosovës janë nominuar dy kandidatë: zoti Glauk Konjufca dhe zonja Fatmire Mullhaxha-Kollçaku. Ftoj përfaqësuesit e propozuesve që para deputetëve të Kuvendit të paraqesin arsyetimin për kandidatët e nominuar për president.

Së pari le të bëhet prezantimi i kandidatit zotit Glauk Konjufca. Zonja Nagavci!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë.

Kam nderin e veçantë që sot para jush të prezantoj kandidatin e Lëvizjes Vetëvendosje për President të Republikës së Kosovës, zotin Glauk Konjufca.

Aktualisht, zoti Glauk Konjufca ushtron detyrën e zëvendëskryeministrit të parë dhe ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe këtë që nga 11 shkurti i vitit 2026. I lindur në korrik të vitit 1981 në Prishtinë, zoti Konjufca ka përfunduar studimet në Filozofi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, duke ndërtuar një profil të theksuar intelektual në fushën e mendimit filozofik dhe kritik. Krahas angazhimit politik, zoti Konjufca ka zhvilluar një veprimtari akademike dhe publicistike. Është autor i veprave “Huti i Minervës”, “Fluturon në muzg”, “Hegel”, “Epistema e Dhomës së Zezë” dhe “Ontologjia e Artit të Shtatë”, të cilat trajtojnë çështje të filozofisë klasike, teorisë së njohjes dhe estetikës së filmit.

Angazhimin politik e ka nisur që nga themelimi i Lëvizjes Vetëvendosje. Në vitin 2010 u zgjodh për herë të parë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe deri më sot është zgjedhur deputet në shtatë legjislatura. Në zgjedhjet parlamentare të 28 dhjetorit të vitit 2025 ai u rendit si deputeti i dytë më i votuar në historinë e zgjedhjeve në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2011-2015 shërbeu si nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në periudhën 2015-2019 ushtroi detyrën e Shefit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, duke udhëhequr përfaqësimin parlamentar të subjektit politik në Kuvend. Në Legjislaturën V ishte zëvendëskryetar i Komisionit për Zhvillimin Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ndërsa në Legjislaturën VI u angazhua si anëtar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe Komisionit për Punë të Jashtme.

Në tetor të vitit 2019 zoti Konjufca u zgjodh sërish deputet dhe më 26 dhjetor të vitit 2019 mori detyrën e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilën e ushtroi deri më 3 shkurt të vitit 2020. Në të njëjtin vit u emërua ministër i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës, detyrë që e mbajti deri në qershor të vitit 2020. Më 22 mars të vitit 2021 u rikthye në postin e kryetarit të Kuvendit duke udhëhequr institucionin legjislativ deri më 15 prill të vitit 2025. Në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit dhe të 28 dhjetorit 2025 u zgjodh sërish deputet, përpara se të merrte përgjegjësinë aktuale në ekzekutiv.

Glauk Konjuca është i martuar dhe babai i tre fëmijëve. Ai jeton me familjen e tij në Prishtinë. Profili i zotit Glauk Konjufca është një profil i presidentit që i nevojitet vendit dhe unë ju ftoj të gjithëve që ta votoni. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zonja Nagavci!

Tani ftoj përfaqësuesin nga Lëvizja Vetëvendosje, deputetin Artan Abrashi, që të bëjë prezantimin e kandidates doktoreshës, deputetes, zonjës Fatmire Mullhaxha- Kollçaku.

ARTAN ABRASHI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

Të nderuar nënkryetarë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Konform rregullave kushtetuese dhe ligjore sot para jush prezantoj ekspozenë e kandidates së radhës, doktoreshës Fatmire Mullhaxha-Kollçaku.

Fatmire Mullhaxha Kollçaku, e lindur më 26 gusht 1966 në Pejë, është doktoreshë dhe specialiste e epidemiologjisë. Ka vijuar studimet postdiplomike dyvjeçare në menaxhment shëndetësor në kuadër të Agjencisë Evropiane për Rindërtim në partneritet me Universitetin e Prishtinës. Karrierën si mjeke e filloi në Organizatën Humanitare “Nëna Terezë” në Prishtinë, ndërsa nga viti 2000 punon në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës. Në kuadër të programit “Hope Fellowship” ajo ka kryer trajnimin dhe vizitën studimore “Leadership Study Tour 2007” në Uashington dhe ka ndjekur trajnime të ndryshme profesionale dhe ka marrë pjesë në dhjetëra konferenca dhe kongrese shkencore si autore dhe bashkautore me punime shkencore. Në politikë është angazhuar që nga viti 2004 dhe është zgjedhur deputete në gjashtë legjislatura të Kuvendit të Kosovës, ku ka kryesuar dy herë Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, një herë Komisionin Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Po ashtu, ka qenë anëtare e Komisionit për Integritet Evropian, Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, si dhe Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale Gjatë Luftës dhe Peticione. Ka bashkëkryesuar Komisionin joformal të deputetëve të gjelbër dhe në legjislaturën e fundit ka kryesuar Këshillin Nacional për Zhvillim të Qëndrueshëm. Aktualisht kryeson Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Punë, Familje, Vlerat e Luftës Çlirimtare dhe Peticione.

Në vitin 2007 ajo u vlerësua nga KDI si deputetja më e zëshme e Kuvendit të Kosovës. Në aspektin organizativ ka shërbyer dy mandate si nënkryetare e Lëvizjes Vetëvendosje, ndërsa aktualisht është anëtare e Kryesisë dhe kryesuese e Këshillit të Përgjithshëm të LVV-së. Po ashtu, fushat e saj të angazhimit përfshijnë shëndetësinë, mirëqenien sociale, zhvillimin e qëndrueshëm dhe të drejtat e njeriut. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar deputet Artan Abrashi!

Meqë në këtë seancë u propozuan dy kandidatë për president, të cilët janë nominuar, në këtë rast ftoj Komisionin për Legjislacion që të mblidhet menjëherë në sallën N10 dhe ta shqyrtojë dokumentacionin nëse kandidatët e nominuar për president i plotësojnë kushtet e përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës dhe pastaj raportin t’ia

paraqesin seancës plenare. Pra, edhe një herë, anëtarët e Komisionit për Legjislacion të mblidhen menjëherë në sallën N10.

(Ndërprerje e incizimit)

Derisa Komisioni për Legjislacion t'i verifikojë listat me nënshkrime dhe dokumentet e tjera, unë edhe një herë po u bëj thirrje deputetëve, të cilët nuk janë të pranishëm që të vijnë në seancën e jashtëzakonshme për zgjedhjen e presidentit.

Në këtë rast, deputetët të cilët mungojnë janë:

Adem Hoxha, Albana Bytyqi, Anton Quni, Ariana Musliu-Shoshi, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bekë Berisha, Besian Mustafa, Blerta Deliu-Kodra, Doarsa Kica-Xhelili, Duda Balje, Elmi Reçica, Enver Hoxhaj, Ferat Shala, Ganimete Musliu, Hykmete Bajrami, Kujtim Shala, Lumir Abdixhiku, Mërgim Lushtaku, Ramush Haradinaj, Time Kadrijaj, Arbnore Salihu, Artan Behrami, Daut Haradinaj, Fadil Hadërgjonaj, Igor Simiq, Jehona Lushaku-Sadriu, Liliana Stevanoviq, Lutfi Haziri, Miljana Nikoliq, Nait Hasani, Përparim Gruda, Rrahman Rama, Sala Jashari, Slavko Simiq, Sërgjan Popoviq, Uran Ismaili, Verica Ceraniq, Vlora Çitaku, Branislav Nikoliq, Adelina Thaçi-Meta, Arben Mustafa, Arjan Tahiri, Bedri Hamza, Besa Kabashi-Ramaj, Eman Rrahmani, Ermal Sadiku, Janina Ymeri, Kujtim Gashi, Milan Kostiq, Nemanja Biševac dhe Ukë Rugova.

Pra, këta janë deputetët që mungojnë sot në këtë seancë. Edhe një herë i ftoj që të vijnë në seancën e jashtëzakonshme sipas obligimeve kushtetuese, bazuar pra edhe në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese që e lexova më herët.

(Ndërprerje e incizimit)

Po ashtu, më lejoni që t'ju njoftoj për procedurën për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës. Sipas nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 106 të Rregullores së Kuvendit, presidenti i Republikës së Kosovës zgjidhet me votim të fshehtë. Për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës gjatë tri votimeve duhet të ketë më së paku dy kandidatë.

Për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, në votimin e parë dhe votimin e dytë kërkohen dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, pra të paktën 80 vota Për. Në votimin e tretë presidenti i Republikës së Kosovës zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, të paktën 61 vota për.

Me këtë rast, pra po e lexoj edhe Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO 4716, pika 64, në mënyrë që raundi i parë i votimit të jetë i vlefshëm, të paktën dy të tretat e të gjithë

deputetëve të Kuvendit duhet të jenë të pranishëm dhe të votojnë. Nëse ky kusht nuk plotësohet, raundi i parë do të jetë i pavlefshëm. Rrjedhimisht, nuk mund të mbahet raundi i dytë.

Në mënyrë që raundi i dytë i votimit të jetë i vlefshëm, numri i njëjtë pra, të paktën dy të tretat e të gjithë deputetëve të Kuvendit duhet të jenë të pranishëm dhe të votojnë. Nëse ky kusht nuk plotësohet, raundi i dytë i votimit do të jetë i pavlefshëm. Vetëm atëherë kur raundi i parë dhe raundi i dytë i votimit janë të vlefshëm, mbahet raundi i tretë. Për të qenë i vlefshëm, raundi i tretë kërkon të paktën praninë dhe votimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Presim derisa Komisioni për Legjislacion ta paraqesë raportin.

Ju lutem deputetë që t'i zini vendet tuaja, sepse Komisioni për Legjislacion e ka përfunduar mbledhjen dhe tani është radha që ta paraqesë raportin. Vetëm deputet Qorrolli, që është zëvendëskryetar i komisionit, sa të mblidhen deputetët të lutem!

Të nderuar deputetë,

Meqë kryetari i Komisionit për Legjislacion, zoti Përparim Gruda, nuk është i pranishëm në këtë seancë, unë e ftoj zëvendëskryetarin e komisionit, zotin Vigan Qorrolli, që Kuvendit t'ia paraqesë raportin. Zoti Qorrolli!

VIGAN QORROLI: Faleminderit, zonja kryetare!

Atëherë, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit ka kënaqësinë që këtij kuvendi t'ia paraqesë raportin për verifikimin e kushteve të kandidatëve të nominuar për president të Republikës së Kosovës.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në pajtim me nenin 106 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit dhe në pajtim me vendimin e mbledhjes plenare, e mbajtur më 5 mars 2026, shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve të nominuar për president të Republikës së Kosovës, zotit Glauk Konjufca dhe zonjës Fatmir Mullhaxha-Kollçaku në lidhje me plotësimin e kushteve të parapara me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për t'u zgjedhur presidenti i Republikës së Kosovës.

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar, konstatoi unanimisht se kandidatët e nominuar për president të Republikës së Kosovës, zoti Glauk Konjufca dhe zonja Fatmire Mullhaxha-Kollçaku, i plotësojnë kushtet e parapara me dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit për presidentin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, zonja kryetare, mund të procedohet me votimin e kandidatëve të nominuar për president të Republikës së Kosovës. Prishtinë, 5 mars 2026.

KRYETARJA: Faleminderit, i nderuar zëvendëskryetar Qorrolli.

Tani vazhdojmë me formimin e Komisionit zgjedhor për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës, i përbërë nga 1 deputet prej secilit grup parlamentar.

Në seancën e sotme kemi dy grupe parlamentare, Grupin Parlamentar të Vetëvendosjes dhe Grupin Parlamentar Multietnik. Andaj, para se të procedojmë ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga 1 anëtar në Komisionin zgjedhor. Zonja Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryetare!

E propozojmë deputetin Sali Zyba.

KRYETARJA: Faleminderit zonja Nagavci! Grupi Multietnik! Deputeti Artan Asllani.

ARTAM ASLLANI: Faleminderit, kryetare!

Në emër të Grupit Multietnik e propozojmë zonjën Emilija Rexhepi.

KRYETARJA: Faleminderit, deputet Asllani!

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votimin e anëtarëve të Komisionit zgjedhor. Votojmë tash. Regjia!

65 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Konstatoj se Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit zgjedhor për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës.

Tani bëhuni gati që të votojmë edhe një herë për prezencë. Regjia, votojmë tash!

65 deputetë janë prezent, 55 deputetë nuk janë prezent.

Edhe një herë po u referohem dispozitave kushtetuese: Neni 86 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë që për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës në votimin e parë dhe në votimin e dytë kërkohen 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, të paktën 80 vota për.

Në sallë janë 65 deputetë, edhe deputeti Gola, i cili është në sallë dhe po e zë vendin e tij. Pra, 66 deputetë. Me këtë rast, konstatoj se nuk ka kuorum për të vazhduar më tutje me votimin.

Disa herë në këtë seancë u bëra thirrje deputetëve, të cilët mungojnë, që të vijnë të jenë të pranishëm në përputhje me kërkesat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, situata është që ata nuk janë të pranishëm. Rrjedhimisht, nuk i kemi 2/3 e deputetëve, 100 nga 120 deputetë, pra nuk janë 2/3, që i bie 80 deputetë në sallë.

Rrjedhimisht, nuk mund të vazhdojmë me votimin e raundeve, sepse siç e dini në votimin e parë duhet të marrim pjesë të paktën 80 deputetë. Edhe në votimin e dytë duhet të marrim pjesë të paktën 80 deputetë. Në votimin e tretë duhet të marrin pjesë të paktën 61 deputetë. A e dëshiron dikush fjalën?

Me këtë rast, po e ndërpres këtë seancë dhe natyrisht që do ta vazhdojmë në qoftë se plotësohen kushtet. Faleminderit dhe shihemi në seancat e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*